



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS FUSHË KOSOVE**

Numri i lëndës: 2021:085825

Datë: 20.11.2023

Numri i dokumentit: 04942569

PPP.nr.665/21

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – DEGA NË FUSHË KOSOVË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, përmes gjyqtarit Freskim Musliu, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit Kompania Rajonale e Mbeturinave “Pastrimi” Sh.A., me seli në Prishtinë, rr. “Bill Klinton”, pa nr., ndaj debitorit D. T. nga Fushë Kosovë, duke vendosur lidhur me prapësimin e paraqitur nga debitori, jashtë seance, më datë 20.11.2023, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

I. APROVOHET si i bazuar prapësimi i debitorit D. T. nga Fushë Kosovë, i datës 14.04.2021, i paraqitur kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.337/2021, të datës 30.03.2021, të Përmbartuesit D. G. nga Prishtina, dhe

II. SHFUQIZOHET Urdhri Përmbartimor P.nr.337/2021, i datës 30.03.2021, i Përmbartuesit Privat D. G. nga Prishtina.

**A r s y e t i m i**

Përmbartuesi Privat D. G. nga Prishtina, me datë 30.03.2021, ka lëshuar Urdhrit Përmbartimor P.nr.337/2021, sipas propozimit për përmbartim në bazë të dokumentit të besueshëm – ekstraktit të verifikuar nga kreditori Kompania Rajonale e Mbeturinave “Pastrimi” Sh.A, kundër debitorit D. T. , për shumën prej 209.3 euro, për borxhin e mbledhur për periudhën 31.07.2010 deri 28.02.2021, me kamatëvonesë prej 8% nga dita e lejimit të përmbartimit, si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Debitori, pas pranimit të urdhrit përmbartimor, brenda afatit ligjor, më datë 14.04.2021 ka paraqitur prapësim, me të cilin e ka kundërshtuar kërkesën e kreditorit si të pabazuar, ngase debitori nuk është në raporte kontraktuale me kreditorin. Ka shtuar se kërkesa e debitorit është e parashkruar, për shkak të rënies në vonesë të kreditorit ndaj debitorit, për borxhin e kërkuar duke filluar nga periudha 01.01.2009 e deri në fund të vitit 01.12.2014 në shumë prej 209.30 euro, kurse për borxhin për vitet e mëvonshme debitori e ka përmbushur në tërësi obligimin. Kështu

ka kërkuar nga gjykata që të aprovohet prapësimi i tij dhe të shfuqizohet urdhri përmbarimor i lejuar nga përmbaruesi privat i lartcekur.

Kreditori në përgjigje në prapësim ka deklaruar se kreditori rregullisht i ka kryer obligimet e veta ndaj debitorit lidhur me bartjen e mbeturinave e debitori asnjëherë nuk ka pasur vërejtje në shërbimet e kreditorit, por se faturat që kreditori ia ka dërguar vazhdimisht debitorit, i njëjti nuk i ka paguar. Sa i përket pretendimit për parashkrim, i njëjti është i pabazuar sepse debitori kohë pas kohe ka paguar faturat dhe kështu e ka ndërprerë parashkrimin. Kështu ka kërkuar nga gjykata që urdhri i përmbaruesit të lihet në fuqi, ndërsa prapësimi i debitorit të refuzohet.

Gjykata pas shikimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës dhe pretendimeve të palëve gjeti se prapësimi i debitorit i datës 14.04.2021, është i bazuar, pasi që kredia e përcaktuar në dokumentin e besueshëm mbi bazën e të cilit është lëshuar urdhri përmbarimor është përmbushur në tërësi nga debitori, ndërsa për periudhën e mëhershme për të cilën kreditori kërkon përmbushjen, i njëjti nuk ka ofruar prova për të vërtetuar ekzistimin e këtij borxhi. Gjykata deri te ky vlerësim erdhi në bazë të kartelës së klientit sipas të cilës është lëshuar urdhri përmbarimor, ku shihet se debitori, për periudhën e cila figuron në kartelë, dhe atë janar 2018 – shkurt 2021 i ka përmbushur të gjitha detyrimet e tij me rregull. Kreditori në propozimin për përmbarim, borxhin nga debitori e ka kërkuar për periudhën 31.07.2010 e deri 28.02.2021, mirëpo në mbështetje të kësaj kërkesë, si provë ka bashkëngjitur dokumentin e besueshëm – kartelën e konsumatorit, në të cilën nuk figuron borxhi i kreditorit nga periudha e kërkuar, pra nga data 31.07.2010, por nga data 29.01.2018, e ku siç u cek më lart, nga kjo datë e tutje me kartelën e konsumatorit vërtetohet se debitori vazhdimisht e ka përmbushur detyrimin ndaj kreditorit, ndërsa për periudhën para muajit janar të vitit 2018 kreditori, siç u cek më lart, nuk ka ofruar prova për ta mbështetur ekzistimin e kredisë së tillë.

Me nenin 71 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore (LPP) është paraparë se “1. Sipas nenit 69 të këtij ligji, prapësimi mund të bazohen vetëm nëse: 1.1. dokumenti, në bazë të cilit është marr vendimi përmbarues ose urdhri përmbarues, nuk ka titull ekzekutiv ose nuk ka tipare të përmbarueshmërisë”. Me nenin 29 të LPP-së është paraparë se “Dokumentin e besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shumat dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”. Duke u bazuar në dispozitat e lartcekura, vërtetohet se dokumenti i besueshëm në bazë të të cilit është lëshuar urdhri përmbarimor nuk ka tipare të përmbarueshmërisë për shumën e kërkuar para datës 29.01.2018, pasi që kjo shumë nuk dihet se si ka ardhur, në të nuk figurojnë muajt të cilët i ka cekur kreditori në propozim për përmbarim, dhe rrjedhimisht kjo e bënë dokumentin e besueshëm të papërshtatshëm për përmbarim.

Nga të lartcekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – DEGA NË FUSHË KOSOVË  
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil  
PPP.nr.665/21, datë 20.11.2023

Numri i lëndës: 2021:085825  
Datë: 20.11.2023  
Numri i dokumentit: 04942569

Gjyqtari,  
Freskim Musliu

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktvendimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, brenda 7 ditësh nga dita e pranimet të këtij aktvendimi. Ankesa eventuale dorëzohet përmes kësaj gjykate.